

ALVIN SARAÇI

**TREGTIA E DURRËSIT DHE E RAGUZËS ME VENEDIKUN  
PAS SHPËRTHIMIT TË LUFTËS SË PARË TË MORESË  
(1684 – 1699)**

Tregtia e Republikës së Raguzës dhe e Durrësit me Republikën e Venecias ka një rëndësi të veçantë, për faktin se Durrësi dhe Raguzë ishin qendrat e para më të vjetra të tregtisë ndërbalkanike. Edhe gjatë periudhës moderne, Raguzë dhe Durrësi edhe pse me një rëndësi më të vogël, përbënin sipas botimit të Piter Shugërit, të vetmet pole për tregtinë e Ballkanit<sup>1</sup>.

Ngulimet e tregtarëve raguzanë në Shqipëri patën një rol thelbësor në shkëmbimet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës së Raguzës, sepse ata orientonin tregtinë tokësore të karvaneve dhe atë detare, të anijeve drejt Raguzës.

Nga ngulimet raguzane në Mesjetë të shpërndara në Shqipëri ndërmjet Vlorës, Durrësit, Sufadës pranë Kepit të Rodonit, Prizrenit, zonës së Shën Vlashit në rrethinat e Shkodrës, që i jepej raguzanëve nga venecianët në vitin 1433<sup>2</sup>, kishin mbetur akoma në këmbë në shek. XVII–XVIII, komunitetet e tregtarëve raguzanë në Pejë, në Novipazar dhe në Shkup, të cilat kishin raporte tregtare me anë të porteve shqiptare me qytetet e bregdetit adriatik dhe Mesinën dhe portet e Siçilisë<sup>3</sup>.

Vetë qyteti i Raguzës u pagëzua me këtë emër nga rrugët tregtare të Venecias që lidhnin Raguzën ballkanike me Raguzën siçiliane dhe

---

<sup>1</sup> Peter F. Sugar & Donald Treadgold, *Southeastern Europe under Ottoman Rule (1354-1804), A history of Eastcentral Europe*, vëll. 5, Seattle: Washington University Press, 1977, f. 108.

<sup>2</sup> Konstantin Jireček, "Albanien in der Vergangenheit", në Ludwig von Thallóczy, *Illyrisch-albanische Forschungen*, vëll.1, München: 1914, f. 108.

<sup>3</sup> Alain Ducellier, *Albanie, Venise et Bisanze au Moyen Age*, London: Variorum reprints, 1987, f. 393, 411, 369, 561, 565; Jahja Drançolli, *Raguzanët në Kosovë prej fundit të shekullit XIII e deri në vitin 1455*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë: 1986; Renzo Paci, *La Scala di Spalato e il commercio veneziano nei Balcani fra Cinque e Seicento (Miscelanea di Studi e Memorie)*, vëll. XIV, Deputazione di Storia Patria per le Venezie, Venezia: 1971, f. 73. Në shek. XVIII, raguzanët e Pejës tregonin me Venecian me anë të portit të Bunës të Shkodrës.

qytetin e Tivarit (Antivari–Antibari), qytet që paraprinte rrugën tregtare të Barit<sup>4</sup>.

Tregtia me portin e Ankonës, i kishte kthyer raguzanët në të preferuarit e Vatikanit<sup>5</sup>. Marrëveshja e parë tregtare ndërmjet Ankonës dhe Raguzës i përket vitit 1199 dhe në versionin e rinovuar të vitit 1397, Raguzës i jepej e drejta që të tregtonte me Ankonën nga një zonë që përfshinte Shqipërinë nga Sazani dhe arrinte deri në Shebenik (Šibenik) të Dalmacisë<sup>6</sup>.

Nga njëra anë, Raguzza ishte një enklavë e kulturës europiano-perëndimore në Ballkan, edhe pse ishte pjesë e Perandorisë Otomane, ndaj së cilës kishte arritur të fitonte autonominë falë tributit (haraçit), që i paguante rregullisht Portës. Nga ana tjetër, Raguzza konsiderohej si pjesë e Adriatikut të huaj nga venecianët sepse i përkiste asaj pjese që venecianët nuk arrinin ta kontrollonin krejtësisht, edhe pse ishte pjesë e vijës bregdetare të Gjirit të Venecias dhe njihej si një *res publica* e ndërtuar sipas modelit venecian<sup>7</sup>.

Raguzza kishte një tregti dhe një lundrim shumë të zhvilluar, saqë pajtonte me qira anijet e saj në portet e Pulias që kishin raporte tregtare me Shqipërinë, Greqinë dhe Dalmacinë dhe gjithashtu me fuqitë tregtare të Venecias, Francës, Anglisë, Holandës dhe portin austriak të Triestes<sup>8</sup>. Anijet me vela të Raguzës mund të ngarkonin deri në 1000 – 1500 ton mall, prandaj ishin të preferuara jo vetëm në hapësirën mesdhetare, por jepeshin me qira në portet e Anglisë dhe të Fiandres<sup>9</sup>.

<sup>4</sup> Milan Shuflaj, *Serbët dhe shqiptarët. Historia e shqiptarëve të Veriut*, Tiranë: Bargjini, 2002, f. 15.

<sup>5</sup> Peter Earle, "The commercial development of Ancona, 1479-1551", në *Economic History Review*, 2<sup>nd</sup> ser., vëll. 22, 1969, f. 28-44.

<sup>6</sup> Mario Natalucci, *Ancona attraverso i secoli: Dalle origini alla fine del Quattrocento*, Ancona: Unione arti grafiche, 1960, f. 411.

<sup>7</sup> Giordano Campos, "Il commercio estero veneziano della seconda metà del 700' secondo le statistiche ufficiali", në *Archivio Veneto*, vol. XIX, Venezia: G. Ferrari, 1937, f. 143-183.

<sup>8</sup> Fernand Braudel, *Il Mediterraneo. Lo spazio, la storia, gli uomini, le tradizioni*, Milano: Bompiani, 2007, f. 46-47. Letërkëmbimi i konsujve venecianë në Trieste dhe Pulia me Pesë të Urtët për Tregtinë, autoriteti venecian që merrej me ligjet që rregullonin tregtinë ndërmjet shteteve të ndryshme dhe Venedikut, është një dëshmi e gjallë e këtij procesi.

<sup>9</sup> *Po aty*.

Në kapërcyell të shek. XVII e XVIII, me daljen në pah edhe të Ulqinit në Adriatik me traditën e tij detare, konsullata franceze dhe holandeze e Durrësit merrte me qira për transportin e mallrave anije raguzane dhe ulqinake<sup>10</sup>. Madje anijet raguzane mbanin edhe flamurin francez gjatë udhëtimeve të tyre, gjë që i shqetësonte venecianët<sup>11</sup>. Në shek. XVIII, anijet angleze, venedikase, franceze dhe holandeze në Mesdhe kishin në gjirin e ekuipazhit të tyre edhe lundërtarë raguzanë dhe shqiptarë<sup>12</sup>.

Një numër i madh i familjeve shqiptare ishin transferuar në Republikën e Raguzës, ku mundën të kenë poste të larta në jetën publike të saj, duke u bërë pjesë edhe e Këshillit të Madh (Gran Consiglio) që drejtonte Republikën e Raguzës<sup>13</sup>. Gjithashtu, diaspora shqiptare e Raguzës ishte ndërmjetëse për tregtinë e drithërave ndërmjet Shqipërisë dhe Raguzës, "perlës së Adriatikut"<sup>14</sup>.

Në fakt, tregtia e drithërave i interesonte më tepër Republikës së Raguzës për pasurinë që ofronte toka e begatshme shqiptare.

Nga mesi i shek. XIV, lidhjet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Raguzës u bënë të ngushta dhe anijet tregtare të Raguzës ishin të pranishme jo vetëm gjatë bregdetit shqiptar në qytetet e Vlorës dhe të Durrësit, por karvanet raguzane penetronin edhe në zonat e hinterlandit shqiptar deri në Gjirokastër apo në Kosovë.

Republika e Raguzës kishte lidhje tregtare me Kastriotët, çka përbën një faqe të veçantë të historisë së tregtisë shqiptare, nga momenti kur hapësira detare joveneciane e Arbërisë së Kastriotëve që quhej porti dhe dogana e Sufadës në grykëderdhjen e lumit Ishëm në Kepin e Rodonit, që nga viti 1415 i përkiste familjes së Gjon Kastriotit, babait të heroit legjendar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ishte bërë një udhëkryq i tregtisë

<sup>10</sup> Zija Shkodra, *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: Letrat e konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë: 1975, dok. 75, f. 147-148, dok.120, f. 223-224, dok. 137, f. 248-249.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> Ardian Muhaj, "Rreth pranisë së detarëve shqiptarë në Angli gjatë Mesjetës", në *Studime historike*, 1-2, Tiranë: 2014, f. 5-33.

<sup>13</sup> Vuk Vinaver, "Dubrovačko-albanski Ekonomski odnosi krajem XVI veka" ["Raportet ekonomike ndërmjet Dubrovnikut dhe Shqipërisë në shekullin XVI"], në *Anali Historijskog Instituta u Dobrovniku*, 1, 1952, f. 213; Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare shek. XV-XIX*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1973, f. 21.

<sup>14</sup> Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare ...*, f. 21.

europiane dhe tregu më i madh i grurit dhe i drurit për Republikën e Raguzës, e cila u kishte njohur privilegjin e pronësisë Kastriotëve mbi Sufadën që në vitet 1417–1420, duke siguruar një pjesë të mirëtë tregtisë me bregdetin shqiptar dhe duke u bërë stimul për tregtarët raguzanë për t’u vendosur me vendbanim në këtë zonë<sup>15</sup>. Lidhjet e ngushta me Republikën e Raguzës u vlejten Kastriotëve, për të marrë qytetarinë fisnike të Raguzës dhe u bënë shtytje për Gjergj Kastriotin që të ndërtonte një kështjellë në Kepin e Rodonit për të mbrojtur territorin<sup>16</sup>.

Që nga shek. XI, Republika e Shën Vlashit, firmoste marrëveshjet e para tregtare me Perandorinë Bizantine, me normanët dhe vendet e Ballkanit: Arbërinë (Shqipërinë, Bullgarinë dhe Serbinë), duke afirmuar pavarësinë e saj politike dhe ekonomike<sup>17</sup>. Në vitin 1210, ligjvënësi dhe princi arbër, Dhimitri i Krujës, u njohu raguzanëve privilegjet tregtare në tokën e Arbërisë<sup>18</sup>. Për 150 vjet, Ragusa u bë pjesë e Republikës së Venecias (1205 – 1358), nga e cila edhe kur u bë e pavarur ndikohej dhe gjente mbështetje, por nga ana tjetër i bënte dhe konkurrencë tregtare<sup>19</sup>. Pas Paqes së Torinos (1358) ndërmjet Republikave të Gjenovas dhe të Venecias, Republika e Raguzës pati mbrojtjen e Mbretërisë së Hungarisë, duke u shkëputur nga tutela veneciane deri në vitin 1526<sup>20</sup>. Periudha e artë e Republikës së Raguzës, që përfshin dhe lulëzimin e tregtisë është në vitet 1350–1575<sup>21</sup>.

<sup>15</sup> Alain Ducellier, *La façade maritime de l’Albanie au moyen age. Durazzo et Valona du XI<sup>e</sup> au XV<sup>e</sup> siècle*, Instituti i Studimeve Ballkanike, Selanik: 1981, f. 61; po ai, “Fronti detar i principatës së Kastriotëve prej fundit të shekullit XIV deri në vdekjen e Skënderbeut”, në *Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike: 12-17 janar 1968*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1968, f. 3, 1-9.

<sup>16</sup> A. Ducellier, “La façade maritime de la principauté des Kastriote”, në *La façade maritime de l’Albanie...*, f. 123; po ai, “Fronti detar i principatës së Kastriotëve ...”, f. 3.

<sup>17</sup> F. Sugar, *Southeastern Europe...*, f. 172.

<sup>18</sup> Anila Omari, *La lingua nello stato di Arbanon*, Palaver, 4, nr. 1, Universiteti i Salentos, 2015, f. 306, 299-313. Jepet i transkriptuar dhe origjinali i traktatit tregtar. <http://siba-ese.unisalento.it/index.php/palaver/article/viewFile/14824/12913> (Kërkuar më dt. 9 qershor 2015)

<sup>19</sup> Sergio Bertelli, *Trittico: Lucca, Ragusa e Boston: tre città mercantili tra Cinque e Seicento*, Roma: Donzelli editore, 2004, f. 54.

<sup>20</sup> *Po aty*.

<sup>21</sup> Oleh Havrylyshyn & Nora Srzentić, "The economy of Ragusa (1300–1800). The tiger of Medieval Mediterranean", në *The Eighteenth Dubrovnik Economic Conference organized by the Croatian National Bank*, Dubrovnik: 27-29 qershor 2012, f. 13.

Duke i paguar taksën e haraçit Perandorisë Otomane nga mesi i shekullit XV, deri në vitin 1806, që shënon ardhjen e Napoleonit e të francezëve dhe fundin e Republikës së Raguzës, republika e vogël tregtare pati konsensusin e Portës së Lartë për shekuj me radhë<sup>22</sup>.

Përsa i përket Shkodrës, distanca e afërt dhe komunikimi direkt me rrugët e Zetës së Epërme dhe të Poshtme i bënin më të lehta raportet tregtare me Kotorrin dhe Raguzën<sup>23</sup>.

Në atë periudhë raguzanët ishin shumë aktivë në portet e Shënkollit, Shën Shirgjit, Bakut të Bunës dhe në deltën e Drinit, duke i dhënë jetë një rruge tregtare tripalëshe Raguzë – Shkodër – Barletë – Bari ose Raguzë – San Kataldo – Deltë e Drinit<sup>24</sup>.

Kjo situatë kishte stimuluar vendosjen e firmave tregtare të Pulias në Raguzë, që merreshin me tregtinë e grurit nga Shën Shirgji i Shkodrës në Venecia dhe të drurit nga Shëngjini i Lezhës në Raguzë, të tregtarëve katalanas që transportonin peshk nga Vlora në Raguzë dhe tregtarëve të Firences që pajtonin anije raguzane për të ngarkuar grurin në brigjet shqiptare dhe tregtonin mëndafsh, valanidh e kërmëz që gjendeshin në Vlorë<sup>25</sup>.

Në shek. XVI, Shqipëria tregtonte me Republikën e Shën Vlashit grurë, dru, katram, tanin për elaborimin (regjien) e lëkurëve, etj<sup>26</sup>.

Në vitet 1397-1469, janë 24 kontratat e tregtarëve raguzanë me Shkodrën dhe sidomos me manastiret benedektine të Shën Shirgjit dhe të Shënkollit dhe 33 kontrata për tregtinë e grurit dhe të drurit me Shëngjinin në periudhën 1404-1468<sup>27</sup>.

<sup>22</sup> Oleh Havrylyshyn & Nora Srzentić, *Institutions always "mattered": explaining property in Medieval Ragusa (Dubrovnik)*, New York, Basingstoke, Hampshire: The Palgrave Macmillan, 2015, f. 55.

<sup>23</sup> John Murray, *A handbook for Travellers in the Ionian Islands, Greece, Turkey, Asia Minor and Constantinople being a guide to the principal routes in those countries including a description of Malta, with index, maps and plans*, London, Paris, Leipzig: 1848, f. 257.

<sup>24</sup> A. Duceilier, *Albanie, Venise et Bisanze ...*, f. 73.

<sup>25</sup> *Po aty*, f. 72.

<sup>26</sup> V. Vinaver, "Dubrovačko-albanski ...", f. 207-231; Peter Bartl, *Ballkani Perëndimor ndërmjet monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Otomane. Për çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*, Tiranë: Dituria, 2011, f. 98-99.

<sup>27</sup> A. Duceilier, *Albanie Venise et Bisanze ...*, f. 60-61.

Mallrat pastroheshin në lazaretet (lazzaretto) e Republikës së Raguzës\*. Politika tregtare e Raguzës, nuk ishte për mbylljen tërësore të tregtisë gjatë epidemisë së murtajes deri në vitin 1377, vit në të cilin Këshilli i Madh i Raguzës morri si vendim për vënien në karantinë të mallrave që arrinin në Raguzë<sup>28</sup>. Lazareti i Raguzës ishte hapur për anijet tregtare në Ishullin e Merkanas (Mrkan), ndërsa për karovanet në Raguzën e Vjetër (Ragusa Vecchia – Cavtat). Në vitin 1457 u ndërtua Lazareti i Dances (Danče), që nuk ishte në një pikë strategjike, prandaj do të ndërtohej një lazaret tjetër në Ploze (Plozze), në afërsi të portit të Raguzës, që u ristrukturua në vitet 1517 – 1523, buzë kalimit të rrugës që lidh Raguzën me Stambollin<sup>29</sup>. Por, në vitin 1534, Senati i Raguzës do të ndërtonte një tjetër lazaret në Ishullin e Lakromës, përballë portit të Raguzës, që do të përfundonte në vitin 1596 dhe do të zgjerohej me dy pjesë të tjera, e cila funksiononte deri në vitin 1691, prapa të cilit ishte Tabori – vend i ndërtuar posaçërisht për strehimin e karvaneve ballkanike dhe në mënyrë të veçantë atyre që arrinin nga Shqipëria, që do të vizitohej në vitin 1664 edhe nga Evlia Çelebi<sup>30</sup>. Në lazaretin e Raguzës ishte e pranishme dhe dogana otomane<sup>31</sup>.

Gjatë periudhës të krizës së drithërave në Republikën e Raguzës në vitet 1685-1687, tentativat e Republikës së Shën Vlashit për dërgimin e një anijeje për të siguruar ngarkesa me grurë nga Shqipëria kishin rezultuar të kota<sup>32</sup>. Për këtë arsye Senati i Raguzës i dërgonte udhëzime ambasadorit të Raguzës në Stamboll, që të nxirrte një licensë apo patentë për anijet raguzane të grurit për Sanxhakun e Shkodrës<sup>33</sup>.

\* Lazareti mban emrin e Shën Lazrit ose Shën Llazarit, një figurë biblike që u ringjall nga Krishti dhe përvijon një vend të rrethuar me ujë në portet e Adriatikut verior dhe të Gadishullit Apenin ku pastroheshin mallrat e mbajtura në karantinë të anijeve. Me këtë emër, që zuri vend në terminologjinë e kohës, pagëzuan për herë të parë venecianët edhe spitalet e sëmundjes së murtajes (la peste).

<sup>28</sup> Nelli Vanzan Marchetti, *Rotte mediterranee e baluardi di sanità, Venecia e i lazzaretti mediterranei*, Venecia, Regione Veneto, Skyra: f. 246-247.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Po aty.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Injac Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1675-1699) (Burime për historinë e Shqipërisë)*, vëll. 4, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, dok. 15, f. 55-56.

<sup>33</sup> Po aty, dok. 35, f. 74.

Duke e parë situatën të vështirë, Raguzat tentonte dhe rrugën e drejtpërdrejtë që të vihej në kontakt direkt me Omer Pashën, Sanxhakbeun e Shkodrës<sup>34</sup>, me anë të ambasadorit Luka Sirdani, i cili i sillte atij disa dhurata dhe dy qen gjahu për ta bindur, por megjithë pëlqimin që kishte marrë në fillim (pasi kishte siguruar një firman nga Sulltani, që lejonte Republikën e Raguzës që të importonte grurë nga zona të ndryshme të Perandorisë Otomane), nuk mundi të arrinte një marrëveshje tregtare, për faktin se Porta e Lartë ishte informuar që autoritetet e Shkodrës kishin lejuar furnizimin me drithëra të anijeve “italiane”, çka linte të kuptohej se bëhej fjalë për anijet venedikase që konsideroheshin rivale gjatë Luftës së Parë të Moresë (1684-1699)<sup>35</sup>. Ndërkohë, Proveditori i Jashtëzakonshëm i Kotorrit kishte kapur anijen raguzane që ishte nisur për të ngarkuar grurë në Shkodër<sup>36</sup>. Kjo sjellje e autoriteteve veneciane ishte rezultat i dekreteve të 20 prillit dhe 26 majit 1629 të Senatit Venecian që sanksiononin monopolin e sigurimit të grurit shqiptar vetëm nga tregtarët venedikas, duke përjashtuar negociimin nga ana e tregtarëve të huaj “il procurarsi dei formenti albanesi che non venissero trattati dai forestieri”<sup>37</sup>.

Përpyqje të tjera diplomatike nga ana e Republikës së Raguzës për të siguruar misrin (il “sorgoturco”), produkt me të cilin ishte e pasur zona e Shkodrës, do të vazhdonin në vitet pasardhëse nga Luka Barka, ambasadori raguzan në Edirne (Edrene), i cili do të ndërhynte në Stamboll për të patur licensën tregtare<sup>38</sup>.

Siç është përmendur, në kapërcyellin e shek. XVII dhe gjatë shek. XVIII, në kohën kur Republika e Raguzës ishte një protektorat austriak nga viti 1684, tregtarët raguzanë të pranishëm në hinterlandin ballkanik të Pejës, Novipazarit dhe Shkupit merrnin pjesë në jetën shpirtërore dhe fetare duke frekuentuar kishat katolike shqiptare. Argjipeshkvi i Shkupit

<sup>34</sup> *Po aty*.

<sup>35</sup> *Po aty*, dok. 212, f. 450-452.

<sup>36</sup> *Po aty*, dok. 18, 2 dhjetor 1685; Raguzat kishte dërguar një ambasador pranë Proveditorit të Jashtëzakonshëm të Kotorrit (Il Proveditore straordinario di Cattaro) për të kërkuar lirimin e anijes raguzane; *po aty*, dok. 32, f. 70-72, Letër e drejtuar ambasadorit të Raguzës në Romë; Johannes Radonić, *Acta et diplomata ragusina, collegit et nunc primum in lucem protulit*, Dubrovnik: 1934, LXXXIX, I, f.187-188.

<sup>37</sup> *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: ASV), Cinque Savi alla Mercanzia (më tej: CSM), 2° s., b. 27/bis, pjesa 2, 6 maj 1629.

<sup>38</sup> I. Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1675-1699) ...*, vëll. 4, dok. 213, f. 452.

Pjetër Bogdani së bashku me dy priftërinj, njëri prej të cilëve ishte kapelan i raguzanëve, merreshin me anën shpirtërore të komunitetit raguzan në këto zona. Argjipeshkvi shqiptar mbante një letërkëmbim me Propagandën Fide dhe me Arqipeshkvin e Padovas të Lumnueshmin Gregorio Barbarigo, nga i cili kishte patur një mbështetje të madhe për misionin e tij dhe për publikimin e veprës së tij: “Çeta e Profetëve”, që do të publikohej në Padova në vitin 1685 (e njohur dhe si vepra e parë e vjetër e dëshmuar në prozë e gjuhës shqipe). Në letrën e 20 majit 1681 që i drejtohet Propagandës Fide, Kryepeshkopi Pjetër Bogdani kërkonte kompensimin e 5 zekinëve\* me vlerë 1600 akçe (aspri), që i kishte dhënë dy misionarëve katolikë përkatësisht të Prizrenit dhe të Trepçes në Kosovë, të quajtur Tomë Raspasani e Giorgio Tollich, të cilët i kishin qëndruar pranë komunitetit raguzan në Novipazar<sup>39</sup>. Argjipeshkvi Pjetër Bogdani na jep dhe kursin e këmbimit të zekinit venecian që ishte në përdorim në Perandorinë Otomane, në Shqipëri dhe në Kosovë, që ishte i barasvlershëm me 320 akçe (aspri)<sup>40</sup>.

Autoriteti venecian i Pesë të Urtëve për Tregtinë gjendej përballë selive konsullore të huaja të Francës, Holandës dhe të Raguzës në Durrës. Republika e Raguzës ishte në konkurrencë tregtare me Republikën e Venecias, prandaj autoritetet veneciane e shihnin Kotorrin si një qendër tjetër grumbullimi të mallrave ballkanikë. Për këtë qëllim, Pesë të Urtët shtynë firma të mëdha tregtare që të vendoseshin nga Venecia në Grykën e Kotorrit, që ta kthenin zonën në një pol tregtar të rëndësishëm, siç kishte ndodhur edhe me Splitin në vitin 1592, në mënyrë që t’i priste rrugën kalimit të mallrave nga Ragusa, dhe konsullatave franceze dhe holandeze në Durrës drejt Ankonës<sup>41</sup>.

Në pak kohë, tregtarët dhe raguzanët me anijet e tyre u kthyen jo vetëm në transportues të mallrave shqiptarë në veçanti dhe ballkanikë në përgjithësi, të domosdoshëm për industrinë evropiane, por u bënë gjithashtu dhe shpërndarës të prodhimeve të manifakturës kryesisht të veshjeve dhe objekteve të luksit nëpërmjet portit të Durrësit në vendet e ndryshme të Ballkanit. Mallrat e importit evropian si metrazhet (veshjet) nga Holanda (i panni d’Olanda) dhe rrobat e mëndafshta (i capi di seta)

\* Njësia monetare veneciane quhej ndryshe dhe dukat.

<sup>39</sup> Odette Marquet, *Pjetër Bogdani, letra dhe dokumente*, Shkodër: Shtëpia botuese Padër Gjergj Fishta, 1997, dok. 238, f. 401 e dok. 242, f.405.

<sup>40</sup> *Po aty*.

<sup>41</sup> ASV, CSM, Reg. 19, 31 gusht 1684, f. 576.

arrinin nga Ankona në Durrës me anë të tregtarëve raguzanë e boshnjakë dhe Shqipëria ishte etapa e parë e shpërndarjes së tyre për në brendësi të Ballkanit<sup>42</sup>. Tregtarët evropianë i kishin këshilluar raguzanët që për shpërndarjen e veshjeve të cilësisë së lartë flasin për ndiqnin më mirë rrugën e Bosnjës<sup>43</sup>.

Nga ana tjetër, Republika e Venecias kontrollonte portet kryesore të Adriatikut, në mënyrë që të kishte në dorë shumicën e tregtisë ballkanike edhe pse nuk mund ta ndalte krejtësisht fenomenin, pasi pika e kalimit të mallrave drejt Ankonës nuk ishte vetëm Raguzë por edhe Narenta e Bosnjës apo dhe anije nga ndonjë port venecian i Dalmacisë që e bënin këtë në fshehtësi.

Ndërkohë, tregtia veneciane gjatë Luftës së Parë të Moresë (1684-1699) njihete një rënie.

Në periudhën e parë katërvjeçare 1684-1688, kur rruga tregtare e Raguzës ishte e hapur, pasqyra e taksave doganore të mallrave venecianë të importit drejt porteve të Shkodrës, të Durrësit, Kurcolas (Korçulës), Fiumes (Rijekës) e Raguzës (Dubrovnikut) të marra së bashku ishte në zbritje nga 20.000 zekinë në vitin 1684, në 14.846 zekinë në vitin 1688 dhe në periudhën e dytë katërvjeçare 1684 – 1688, atëherë kur rruga tregtare e Raguzës ishte e mbyllur, pati një zbritje të mëtejshme nga 5.425 zekinë në vitin 1684 në 732,2 zekinë në vitin 1688<sup>44</sup>.

Deri në vitin 1699, konsulli francez i Durrësit, Balthazar (Balthasar) Comte që kishte pranuar anijet që ktheheshin nga Venecia me mallra importi dhe metrazhe (veshje) të manifakturës veneciane që tregtoheshin me anë të tregtarëve shqiptarë drejt Shqipërisë, i shkruante Sekretarit të Shtetit të Oborrit Mbretëror (Secrétaire d'État à la Maison du Roi) Louis Phélypeaux, kontit de Pontchartrain, që të merrte opinionin e mbretit të Francës se a duhet t'i pranonte apo jo produktet e manifakturës veneciane në Durrës<sup>45</sup>.

Para dhe gjatë Luftës së Parë të Moresë (1684-1699), shumica e mallrave të Shkodrës dhe të Shqipërisë kalonin drejt Republikës së Raguzës dhe një pjesë prej tyre shpërndahej në Venecia<sup>46</sup>.

<sup>42</sup> *Po aty*, CSM, Reg. 19, 10 nëntor 1695, f. 537.

<sup>43</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 27/bis, 10 shtator 1695.

<sup>44</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 350, f. 400.

<sup>45</sup> I. Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1675-1699) ...*, vëll. 4, dok. 228, f. 476-477.

<sup>46</sup> *ASV*, CSM, 2° s., b. 350, n. 5.

*Taksa doganore e listës së mallrave në doganën e Raguzës ishte si vijon<sup>47</sup>:*

Sasi	Malli	Taksa doganore e shprehur me monedhën e Venecias
1 ballë/baule (balla)	10 copë lëkurë gjedhi	1 zekin dhe 14 lire
1 ballë/baule	4 copë lëkurë bualli	2 zekinë
1 koli me dyll (collo)	prej 280 librash* ( rreth 140 kg)	3 zekinë e 10 lire
1 ballë / baule	prej 10 lëkurësh dhie (cordovane)	2 zekinë e 10 lire
1 ballë / baule	10 lëkurë dashi (moltonine)	1 zekin 1 lire e 14 grosh (soldi)
1 ballë / baule	20 lëkurë (chiosoline)	1 zekin e 5 lire
1 ballë / baule	lëkurë të holla të paelaboruara të Levantit prej 280 librash	10 zekinë e 10 lire
1 arkë (cassa)	këmisha të mëndafshhta (imbogli)	12 zekinë
1 arkë	kumash (broccati) të qendisur me ar të cilësive të ndryshme prej 280 librash	12 zekinë
1 ballë / baule	metrazhesh (veshjesh) (panni veneziani)	13 zekinë e 10 lire
1 koli	sheqer / kafe prej 289 librash të vogla	6 zekinë e 16 lire
1 koli	mallra të zakonshme, rruaza qelqi të Muranos (contaria)	3 zekinë e 8 lire

Me anë të konsullatës veneciane, Durrësi bënte të mundur kalimin e mallrave ballkanikë drejt Venecias duke i ndërruar drejtimin një pjese të tregtisë që kalonte nga Raguzë.

Tregtia ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës së Venecias në fillimet e saj nuk u ndikua nga Lufta e Parë e Moresë, por duke iu referuar të dhënave deri në vitin 1687, ecte me ritmin e asaj të Raguzës.

Këtë pohim e forcon më tepër fakti se më 6 qershor 1687, regjistrohet prania e anijeve tregtare të mudës së Durrësit dhe Raguzës në Venecia dhe të tregtarëve të Durrësit që donin ta mbanin në këmbë me çdo kusht tregtinë me Venecian<sup>48</sup>.

<sup>47</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 350, n. 5.

\* *libra* – njësi matëse e Venecias, baraz me 500 gr.

<sup>48</sup> *Avvisi ordinari e straordinario d'Italia degli anni 1686-1687*, vëll. IV, Vienë: Gio. Van Gheten, 1687, Posta e rregullt nga Venecia, 6 qershor 1687.

Në këtë hapësirë kohore ishte konsull venecian i Durrësit Tommaso Cotoni (Thoma ose Tomë Kotoni) nga Janina, që pasonte në këtë post vëllain e tij Pietro (Petro, Pjetër), që rridhte nga një familje tregtarësh të mëdhenj dhe nënkonsull Giorgio (Zorzi) Cumano, që në një dokument shfaqet në momentin e shpërthimit të Luftës së Parë të Moresë si ikanak në Venecia, për të mos u kapur nga turqit, siç ndodhte zakonisht me fillimin e luftës<sup>49</sup>. Ai kishte lundruar në muajt mars – prill të vitit 1684 me anijen “Mbreti David” me kapiten hebre dhe ishte vënë në Venecia në rolin e ndërmjetësuesit për kalimin drejt Durrësit të tregtarëve otomanë të kapur me fillimin e Luftës Veneto-Turke<sup>50</sup>. Sigurisht, mund të shtrojmë pyetjen se a qëndroi e hapur tregtia gjatë viteve të luftës së Moresë!? Këtij misteri i japin zgjidhje të dhënat e Doganës së Detit të Venecias (Dogana da Mar). Është për t’u theksuar gjithashtu se edhe tregtia e Raguzës me Venecian u mbyll në vitet e mëvonshme 1689-1693, pavarësisht se porti i Splitit ishte mbyllur që në vitin 1684<sup>51</sup>.

Megjithatë, tregtia veneciane me Durrësin nuk u ndal edhe kur nënkonsulli venecian e la qytetin, sepse ia kishte deleguar të drejtat e taksës konsullore konsullatës franceze dhe holandeze dhe për më tepër në vitin 1688, Xhorxhio Kumano u bë konsull holandez i Durrësit<sup>52</sup>.

Të dhënat statistikore të plotësuara nga doganieri i Venecias Guaco (Guazzo), gjatë periudhës trevjeçare 1684-1687, vënë përballë të dhënat statistikore të të ardhurave nga taksat doganore të Republikës së Venecias nga tregtia me Republikën e Raguzës dhe me Durrësin. Po t’i referohemi tre tabelave që vijojnë vihet re se shifrat e të ardhurave doganore të Venecias nga tregtia e të dy qyteteve (Raguzës dhe Durrësit) nuk paraqesin ndryshime të mëdha. Duhet patur parasysh se Venecia kishte stimuluar më shumë tregtinë e Durrësit, që ta kishte si kundërpeshë për konkurrencën që i bënte Republika e Raguzës. Nga ana tjetër, edhe tregtia e Shkodrës ndahej ndërmjet Kotorrit dhe Raguzës dhe tregtarët shkodranë frekuentonin fare pak portin e Durrësit, sepse e kishin për traditë që të ndiqnin rrugët tregtare që çonin drejt Raguzës, prandaj merita e Durrësit është edhe më e madhe, sepse shifrat e tregtisë së Shkodrës shkonin në favor të bilancit tregtar raguzan. Rritja e tregtisë së

<sup>49</sup> ASV, CSM, 2° s., b. 28, 4 maj 1699.

<sup>50</sup> *Po aty*.

<sup>51</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 350, n. 396.

<sup>52</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 28, 25 shtator 1704.

Durrësit është e dukshme, madje në vitin 1684-1685, Durrësi e kalon tregtinë e Raguzës me Venecian<sup>53</sup>.

Ndër mallrat kryesorë të Durrësit sipas cilësisë, siç rezulton nga tabelat në vijim, ishin: leshi, dylli, lëkurët (cuori sechi, cordovane, agneline e chiosoline), batanijet dalmate (schiavine), erëzat, mbulesat e krevatit me lesh të ashpër, mëndafshi, kërmëza, filli ose fijet (prej pambuku, mëndafshi ose leshi), etj.

*Të ardhurat nga taksat doganore të mallrave të tregtisë së Republikës së Raguzës dhe të Durrësit me Republikën e Venecias nga maji i vitit 1684 deri në prill të vitit 1685<sup>54</sup>:*

Tregtia e Republikës së Raguzës				Tregtia e Durrësit			
Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat dogano-re në dukatë	Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë
Dyll	3.178	865.586	2885,7	Dyll	3.176	788.310	2.627,17
Lëkurë dhie (cordovane)	1.325	149.578	1.495,78	Lëkurë dhie (cordovane)	440	97.387	973,21
Lesh	1.419	184.903	410,21	Lesh	2.386	347.206	771,14
Mëndafsh	4	232	6,4	Mëndafsh	23	5.761	153,15
Tresulfur arseniku (orpimento)	48	8.768	10,23	Shafran (zafferano)	4	463	12,11
Tapet / rrugicë për gondola (zenie)	145 copë		7,6	Kërmëz (grana)	18	4.427	84,13
Squodemo		170.000	14,4	Veshje të bardha me çmim të ulët (salonicchie)	86	2.254	275,12
Lëkurë peshku mustak që përdorej për lidhjen e librave (sagrini)	440 copë	8.768	10,23	Pëlhura pambuku të stolisura me vizatime (indiane)	1	216	8,15
Lëkurë (cuori sechi)	10.607 copë		441,32				
Lëkurë (chiosoline)	784 copë		11,22	Lëkurë (Cuori sechi)	1.188 copë		49,12
Batanije dalmate (schiavina)	1.086 copë		43,14	Koperta / mbulesa krevati me	183 copë		17

<sup>53</sup> Po aty.

<sup>54</sup> Po aty, CSM, 2° s., b. 350, n. 396.

				lesh të ashpër (felzade)			
<b>Tregtia e Raguzës me Venecian</b>		<b>Shuma në total:</b>	<b>5445,13 dukatë</b>	<b>Tregtia e Durrësit me Venecian</b>	<b>Shuma në total:</b>	<b>5.527,14 dukatë</b>	

*Të ardhurat nga taksat doganore të mallrave të tregtisë së Republikës së Raguzës dhe të Durrësit me Republikën e Venecias nga maji i vitit 1685 deri në prill të vitit 1686<sup>55</sup>:*

Tregtia e Republikës së Raguzës me Venecian				Tregtia e Durrësit me Venecian			
Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në Libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë	Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë
Dyll	6.253	171.467	5.715,13	Dyll	4.418	113.879	3.796,16
Lëkurë (cordovane)	2.893	281.520	2.816,5	Lëkurë (cordovane)	516	91.356	913,13
Lesh	1.948	31.035	689	Lesh	4.355	620.147	1.378,3
Tresulfur arseniku (orpimento)	26	5.696	7,3	Lëkurë qengji (agnelline)	16	3.550	47,8
Veshje të bardha me çmim të ulët (saloniche)	3	104	12,12	Gurkaliose sulfatbakri (pietre da cavallo o solfato di rame)	2	264	5,6
Lin (lino)	1	104	0,8	Temjan (incenso)	2	392	2,15
Sfungjer (sponze)	1	104	0,13	Shafran (zafferano)	5	439	14,15
	Thasë (Fagotti)			Sfungjer (sponze)	21	1.570	7,2
Mëndafsh	17	2.047	54,14	Lëkurë (bocassini)		681	68,1
Kanavacë e ngjyrosur dhe e gomuar (bocassini)		278	27,19		Thasë (fagotti)		
	copë			Mëndafsh	241	68.403	1.824,2
Lëkurë (cuori sechi)	12.407 copë		516,23				
Lëkurë (chiosoline)	576 copë		85,1	Koperta ose mbulesa krevati me lesh të ashpër (felzade)	118 copë		21,13
Batanije dalmate (schiavine)	256 copë		10,18	Erëza (saporì)	77 copë		
Lëkurë peshku	1.425		57	Fill ose fije	2 copë		

<sup>55</sup> *Po aty*, CSM, 2° s., b. 350, n. 396.

mustak që përdorej për lidhjen e librave (sagrini)	copë			(leshi, pambuku ose mëndafshi) (filati)			
Tapet / rrugicë për gondola (zenie)	157 copë		7,2	Shandanë (Lucernieri)			17,8
Bakër		160	1				
Mbulesa prej leshi për gondolat (rasse)	200 copë		1				
<b>Tregtia e Raguzës me Venecian</b>		<b>Shuma në total:</b>	<b>10.004,8 dukatë</b>	<b>Tregtia e Durrësit me Venecian</b>		<b>Shuma në total:</b>	<b>9.018,23 dukatë</b>

*Të ardhurat nga taksat doganore të mallrave të tregtisë së Republikës së Raguzës dhe të Durrësit me Republikën e Venecias nga maji i vitit 1686 deri në prillin e vitit 1687<sup>56</sup>:*

Tregtia e Republikës së Raguzës				Tregtia e Durrësit			
Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë	Lloji i mallit	Nr. i kolive (colli)	Pesha në libra (libbre)	Të ardhurat doganore në dukatë
Dyll	5.197	1.433.365	4.777	Dyll	2.179	553.149	1843,20
Lëkurë (cordovane)	1.812	203.047	2.030,6	Lëkurë (cordovane)	544	89.839	898,9
Lesh	1.870	280.208	622,16	Lesh	5.829	862.667	1917,1
Tresulfur arseniku (orpimento)	42	8.976	11,5	Kërmëz (grana)	65	12.571	251,10
Mbulesa prej leshi për gondola (rasse)	70		8	Fill ose fije (leshi, pambuku ose mëndafshi (filadi)	9	2.354	15,16
		copë		Damask (damaschini)	9	1.567	62,16
Damask (damaschini)	8	1.440 copë	57,14	Gurkali ose sulfat bakri (Pietre da cavallo)	1	256	5,3
Veshje të bardha të lira (salonicchi)	6	198 copë	23,18	Lëkurë qengji (agnelline)	37	8.618	114, 22
		copë		Lëkurë keci (cappretti)	2	274	0,22
Lëkurë keci (cappretti)	650 copë		2,40	Llulla (pipe)	2		2
Lëkurë (cuori secchi)	8.562 copë		356,18	Sfungjer (sponze)	8	1.425	7,3
Batanije (schiavine)	1.363 copë			Mëndafsh	142	36.063	961,16
Bishta të	80		6	Veshje të bardha	240	6.064	727,16

<sup>56</sup> *Po aty*, CSM, 2° serie, b. 350, n. 397.

gëzof të shqarthe (Codede fuine)	copë			me çmim të ulët (salonicchi)			
Lëkurë (chiosoline)	414 copë		62,2	Lëkurë (cuori secchi)	988 copë		41,4
Kopertë / mbulesa krevati me lesh të ashpër (felzade)	81 copë		14,20	Batanije dalmate (schiavine)	21.728 copë		905,8
Tapetë / Rrugica për gondola (zenie)	6 copë		0,7	Mbulesa krevati melesh të ashpër (felzade)	607 copë		111,11
Lëkurë peshku mustak që përdorej për lidhjen e librave (sagrini in pelle)	100		4	Lëkurë (chiosoline)	32 copë		4,19
				Kanavacë e ngjyrosur dhe e gomuar (bocassine)		103	10,7
				Erëza (saporì)	939 copë		46, 23
<b>Tregtia e Raguzës me Venecian</b>		<b>Shuma në total:</b>	<b>8.062,12 dukatë</b>	<b>Tregtia e Durrësit me Venecian</b>		<b>Shuma në total:</b>	<b>7.927,10 dukatë</b>

Porti i Durrësit ku kalonte tregtia e vendeve të ndryshme: anglezëve, fiamingëve, francezëve e raguzanëve, ishte në duart e venecianëve, të cilët realizonin një vëllim të madh të tregtisë që u sillte atyre të ardhura të larta, megjithë Luftën Veneto-Turke<sup>57</sup>. Konkurrenca pas rihapjes së tregtisë të portit të Durrësit në mbarim të luftës së Kretës (1671) dhe dominimi i emporiumit venecian e kishte kufizuar tregtinë e Republikës së Raguzës. Për këtë arsye Republika e Raguzës bëri dy tentativa me pashain e Bosnjës, i cili kishte një influencë të madhe tek Sulltani, për të mbyllur mudën tregtare të Durrësit\*. Tentativa e parë më 28 dhjetor 1685 dhe e dyta më 8 gusht 1685, qenë udhëzimet sekrete që Senati i Raguzës i dha ambasadorit të saj në Stamboll Secondo Gozze, që të ndërhynte

<sup>57</sup> Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, *Shqipëria nën sundimin feudal – ushtarak otoman (1506 – 1839), Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. 3, Tiranë: 1962, dok. 107, 8 gusht 1688, f. 153-154; Jovan Radonić, *Dubrovačka acta i povelje – Acta et diplomata Ragusina*, Mladja Srbije: 1934, LD I/XC, f. 189-191.

\* Pashai i Bosnjës kishte në dorë hapjen dhe mbylljen e tregtisë ndërmjet Ballkanit dhe Venedikut.

pranë pashait të Bosnjës, në mënyrë që të mbyllej porti i Durrësit me pretekstin se pengonte tregtinë e Republikës së Raguzës, nga e cila ajo siguronte shumën për t'i paguar haraçin Portës së Lartë<sup>58</sup>, edhe pse këto përpjekje nuk patën ndonjë rezultat të madh, për faktin se Durrësi ishte kthyer tashmë në një metropol dhe udhëkryq i tregtisë ndërkombëtare<sup>59</sup>.

Dinamizmi i shkëmbimeve tregtare të Raguzës do të thoshte mirëqenie për Perandorinë Otomane, sepse rruga tregtare më e rëndësishme kalonte nga Edirne (Edreneja, Adrianopoja) në Raguzë dhe për këtë arsye ishte konsideruar me rëndësi të veçantë për Portën e Lartë<sup>60</sup>. Nuk është rastësi që gjatë Traktatit të Paqes të Karlovicit (Sremski Karlovski) në janar të vitit 1699, ndërmjet Republikës së Venecias dhe Portës së Lartë, Republika e Venecias zotohej se do të linte të lirë rrugën tregtare që lidhte Perandorinë Otomane me Republikën e Raguzës<sup>61</sup>.

### *S u m m a r y*

#### THE TRADE OF DURAZZO AND RAGUSA WITH VENICE ON THE OUTBREAK OF THE FIRST MOREAN WAR (1684 – 1699)

Durazzo and the Republic of Ragusa were among the most ancient trade routes and “the only” transit points during the modern period for the inter-Balkan trade with the Republic of Venice. The close trade relations between Albania and the Republic of Ragusa flourished on account of the significant

<sup>58</sup> I. Zamputi, S. Naçi, Z. Shkodra, *Shqipëria nën sundimin feudal ...*, dok. 107, 8 gusht 1688, f. 153-154.

<sup>59</sup> *Po aty*, dok.29, 6 korrik 1686, f. 68-69.

<sup>60</sup> Stanford J. Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne (1280-1808)*, vëll. I, "Perandoria e Gazinjve. Ngritja dhe rënia e Perandorisë Osmane (1280-1808)", përkthyer nga Olsi Jazexhi, Tiranë: Jehona Study Center, 2006, f.195-197 [Stanford J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and the Modern Turkey*, "Empire of the Gaziz. The rise and decline of the Ottoman Empire, 1280-1808", 1, Cambridge, London, New York, Melbourne: 1976].

<sup>61</sup> Gabriel Bonnot de Mably, *Il diritto pubblico dell'Europa fondato sopra i trattati del signor abate di Mably*, traduzione dal francese, Venezia: Giovanni Gatti, 1784-1787, vëll. 1-3, Artikulli 9 i Traktatit të Karlovicit që vendoste paqen ndërmjet Venecias dhe Portës së Lartë flet dhe për rrugën tregtare të Raguzës me qytetet e mëdha të Perandorisë Osmane, f. 188-189.

contribution of the Ragusan traders' settlements in medieval times in various cities of Albania such as: Scutari (Shkodra), Durazzo (Durrës), Valona (Vlora), Prishten (Prizren), that were still present in the turn of the XVII Century and the beginning of the XVIII Century in the cities of Ipek (Peja), Scopje (Shkup) and the area of Novipazar. On the other hand, even the Albanian diaspora at the Republic of Ragusa that held high offices, had in the hands the grain trade.

From 1415 onwards, Suffada at the Rodoni Cape that belonged to the Castriots' family, became the biggest Ragusan grain and timber market. The Venetian trade authority of Cinque savi alla mercanzia had to deal with the competition not only of the Republic of Ragusa, but also of the French and the Dutch consulate in Durazzo that opened after the Peace Settlement following the Cretan War (1645 - 1669) and used to trade with Ancona. For this reason, the rise of the port of Durazzo is to be connected also with the commercial policy of St. Mark's Republic, in order to counterbalance the Ragusan competition. The trade relations of Durazzo and the Republic of Ragusa with the Republic of Venice went on respectively until 1687 and 1689, although the outburst of the First Morean War (1684 – 1699). Trade between the Republic of Venice and the Sublime Porte restarted after the Peace Treaty of Carlowitz (Sremski Karlovci) of 1699.

During the Morean war, the consul of Venice in Durazzo was Tommaso Cotoni (Thoma or Tomë Kotoni) from Ioannina (Janina) and the vice-consul Giorgio Cumano.

In the end, the Venetian trade in Albania still continued by means of the French and the Dutch consulate in Durazzo as in 1688 Giorgio Cumano, the former vice-consul of Venice became the Dutch consul at Durazzo.

In this period, trade decreased. Anyway, the statistics of the revenues of the custom duties of the Dogana da Mar of Venice for the three year period 1684-1687 of the Ragusan and Durazzo trade with the Republic of Venice bring proof that there is not much difference between them, furthermore during the period 1684-1685, the revenues of the custom duties of Durazzo outbalanced those of the Republic of Ragusa of 82 ducats.

